



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.33, datë 20/07/2005

**“PËR KALIMIN KAPITAL TË ASETIT TË NDËRMARRJES NR.3 “ZYRA
+ MAGAZINA” NË RR.NDRE MJEDA, BASHKISË TIRANË SI DHE
NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË KËTIJ OBJEKTI NË QENDËR
SOCIALE KOMUNITARE “FABRIKË KREATIVITETI”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, pika 3/II/c, neni 11, pika 3/c dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.153, dt.03/04/1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” pika 2, gërma “dh”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Kalimin kapital të objektit “Zyra + Magazina” në Rr. “Ndre Mjeda” nga Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit në aparatin e Bashkisë së Tiranës me qëllim ngritjen e Qendrës Sociale Komunitare “Fabrikës së Kreativitetit” me këto të dhëna:
 - Zyra dhe Magazina në Rr. “Ndre Mjeda”
 - Sipërfaqe totale 2357.4 m² nga të cilat 983.1 janë sipërfaqe nën objekt
 - Vlerë kontabile 12000 lekë
2. Në zbatimin e pikës 1 të këtij Vendimi, të kryhet ndryshimi i destinacionit të këtij objekti në qendër sociale dhe të kryhen veprimet kontabile pranë Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit dhe Aparatit të Bashkisë së Tiranës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Aseteve, Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit dhe Aparati i Bashkisë së Tiranës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI